



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCESVERBAL NR. 10
Datë 01.08.2026 ora 09 : 30 ⁰⁰

Zhvillohet mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Në mbështetje të njoftimit të bërë nga Kryetarja e Këshillit Bashkiak në grupin e whatsapp të Këshillit me këtë rend dite,

1. “ Për të shqyrtuar dhe mbajtur një qëndrim zyrtar nga ana e Këshillit Bashkiak në lidhje me draftin përfundimtar të propozuar nga deputetët e mazhorancës në parlament për reformën administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet shkrirja e Bashkisë Rrogozhinë”.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Erind Tosku, Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Altin Tosku, Lorena Baku, Sokol Gosa, Besnike Coraj, Dhurata Meka, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani, Mukades Gixhari.

Merr pjesë online në këtë mbledhje :

Mitat Daja.

Mungojnë :

Saimir Cani, Merilin Saraçi, Lije Dedej,

Të ftuar :

1. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit.
2. Të gjithë këshilltarët.

Drejton mbledhjen :



Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 18- Këshilltarë përfshirë dhe z. Mitat Daja i cili e ndjek mbledhjen elektronikisht.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Sot jemi mbledhur në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për të shqyrtuar një çështje që prek drejtpërdrejt të ardhmen e komunitetit tonë, identitetin e Bashkisë Rrogozhinë dhe të drejtën e qytetarëve tanë për të pasur një vetëqeverisje vendore funksionale, të afërt dhe përfaqësuese.

Drafti i ri i organizimit administrativo-territorial, i cili parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë, ka ngjallur shqetësim të ligjshëm te qytetarët tanë, te institucionet vendore dhe te të gjithë ata që besojnë se zhvillimi i një territori nuk matet vetëm me kufijtë administrativë, por me potencialin, historinë, identitetin dhe rezultatet që ai ka arritur.

Këshilli Bashkiak Rrogozhinë është institucioni që përfaqëson drejtpërdrejt qytetarët e kësaj bashkie. Prandaj, është detyrimi ynë institucional dhe moral të ngremë zërin kur cenohet interesi i komunitetit që përfaqësojmë.

Bashkia Rrogozhinë nuk është një njësi administrative pa histori. Ajo është shtëpia e rreth **43 mijë banorëve**, sipas Regjistrit të Gjendjes Civile, organizohet në **5 njësi administrative** dhe përfshin **36 fshatra**, secili me traditat, vlerat dhe kontributin e tij në zhvillimin e këtij territori.

Që prej reformës territoriale të vitit 2015, Bashkia Rrogozhinë ka dëshmuar se është një bashki funksionale, me kapacitete administrative dhe me vizion zhvillimi. Në këto vite janë realizuar investime të rëndësishme dhe janë krijuar mundësi të reja për ekonominë vendore.

Sot Rrogozhina administron një nga vijat bregdetare me potencialin më të madh turistik në vend, atë të **Spillesë** dhe **Vilë-Bashtovës**. Pas vitit 2015, kjo zonë u rivitalizua me investime të rëndësishme në infrastrukturë dhe shërbime, duke u kthyer në një destinacion të rëndësishëm për mijëra pushues dhe një burim zhvillimi për biznesin lokal, fale vizionit të bashkise.

Po aq i rëndësishëm është edhe potenciali ynë bujqësor. Tokat pjellore të Rrogozhinës dhe tradita e admirueshme në bujqësi kanë bërë që ky sektor të mbetet shtylla kryesore e ekonomisë sonë. Nuk është rastësi që **fshati Gërmenj** është përzgjedhur në Programin Kombëtar "100 Fshatrat", si një ndër zonat me perspektivë të veçantë zhvillimi.

Rrogozhina ka ditur të ndërtojë identitet edhe në kulturë e sport. Në sport kemi dëshmuar se kur vullnetit dhe vizioni institucional bashkohet me investimet serioze, rezultatet janë të



jashtëzakonshme. Bashkëthemelimi i shoqërisë aksionare "**Futboll Klub Egnatia**" në vitin 2020 hapi një kapitull të ri për sportin shqiptar. Sot kemi një stadium modern, **Arena Egnatia**, ku janë zhvilluar ndeshje të kompeticioneve evropiane. Klubi ynë është shpallur kampion i Shqipërisë për tre vite radhazi, fitues i dy Kupave të Shqipërisë dhe vazhdon të përfaqësojë me dinjitet vendin tonë në arenën evropiane. Këto nuk janë vetëm suksese sportive; ato janë dëshmi e qartë se Rrogozhina di të zhvillohet, di të tërheqë investime dhe di të ndërtojë të ardhmen.

Pikërisht për këtë arsye, ne besojmë se çdo reformë administrative duhet të mbështetet në analiza objektive, në dialog të hapur me komunitetet dhe në argumente të qarta. Nuk mund të pranohet një vendimmarrje që prek jetën e mijëra qytetarëve pa një proces transparent konsultimi dhe pa prova se një ndryshim i tillë do të sillte përmirësim të shërbimeve dhe zhvillimit.

Sot, pavarësisht bindjeve politike që secili prej nesh përfaqëson, na bashkon një qëllim shumë më i madh: mbrojtja e interesit të Bashkisë Rrogozhinë dhe e qytetarëve që na kanë besuar përfaqësimin e tyre.

Është inkurajuese që ky Këshill Bashkiak ka gjetur gjuhën e përbashkët dhe po paraqitet me një qëndrim **unanim**, duke dëshmuar se, kur bëhet fjalë për të ardhmen e Rrogozhinës, interesi publik qëndron mbi çdo dallim politik. Mesazhi ynë nuk është kundër reformave. Ne jemi në mbështetje të çdo reforme që sjell zhvillim, efikasitet dhe përmirësim të jetës së qytetarëve. Por jemi kundër çdo vendimmarrjeje që dobëson autonominë vendore, largon vendimmarrjen nga qytetarët dhe cenon identitetin e një bashkie që ka dëshmuar se ka potencial, kapacitete dhe rezultate.

Rrogozhina meriton të mbetet një njësi e pavarur e vetëqeverisjes vendore. E meriton për historinë e saj, për njerëzit e saj, për potencialin ekonomik, bujqësor e turistik, për kulturën, për sportin dhe mbi të gjitha për të ardhmen që po ndërton.

Me këtë bindje, Këshilli Bashkiak unanimisht propozuan të miratojnë projekt-vendimin për kundërshtimin e draftit të ri të organizimit administrativo-territorial, duke përcjellë një mesazh të qartë dhe të përgjegjshëm në mbrojtje të interesave të Bashkisë Rrogozhinë dhe të gjithë qytetarëve të saj. E hedhim në votim projektvendim, "Për kundërshtimin e draftit të ri të organizimit administrativo-territorial që parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë". Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Edhe z. Mitat Daja është dakord. Miratohet.

-Miratohet me 18-vota pro, 0 kundër, 0 abstenim projektvendimi, "Për kundërshtimin e draftit të ri të organizimit administrativo-territorial që parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë".

Vendim nr. 31. Miratohet me 18-vota pro, projektvendimi i propozuar unanimisht nga anëtarët e këshillit, "Për kundërshtimin e draftit të ri të organizimit administrativo-territorial që parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë".



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Mukades Gixhari . Kjo ishte e gjithë arsyeja përse ne e bëmë këtë mbledhje urgjente.

Hekuran Xhani . Kjo mbledhje i shërben më shumë se çdo gjë tjetër interesit qytetar edhe unë shpreh jo vetëm votën time pro këtij vendimi por mendoj që ne si përfaqësues të qytetarëve dhe në këtë kuvend të vogël t'i paraprijmë qytetarëve në protestë deri në arritjen dhe realizimin e këtij vendimi që kemi marrë ne sot si përfaqësues të këtyre qytetarëve të zgjedhur prej votës së tyre, unë falemndoj të gjithë kolegët e mi për unanimitetin që treguan në këtë vendimarrje sot. kjo i shërben Rrogozhinës kjo i shërben qytetarëve

Mukades Gixhari . Ju faleminderit të gjithëve . Mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur Ky vendim do i përcillet institucioneve përkatëse. Atëherë diskutime ska...

-Mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Ju faleminderit !

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 10 : 00⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total : 7 min ; 31 sek .
- Ky procesverbal i përmbledhur mbyllet në faqen 4 (katër).

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**

**KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI**